



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut

Opština Istok
Municipality of Istog

01 Numër:...../2018
Data:.....2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Rregullore Komunale Nr. .../2018

KUVENDI I KOMUNËS

Projekt- Plotësim Ndryshimi i

**RREGULLORES
KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA**

MARS-2018

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.1 pika c), dhe nenit 40 paragrafit 40.2 pika a) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), nenit 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27/2008) dhe nenit: 33 paragrafi 1 dhe 6 dhe neni 34 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Istogut 01nr.62/2010, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë:....., miratoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen të gjitha të hyrat e mbledhura nga komuna duke përfshirë taksat për kryerjen e shërbimeve, ngarkesat dhe gjobat e ndryshme të cilat do të arkëtohen nga Drejtorit Komunale.

Neni 2 Drejtoria për Administratë

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Regjistrimi i Statusit Civil	
1.1. Regjistrimi i vonuar i lindjes me Aktvendim në LAL pas 1 muaji;	5 20
1.2. Regjistrimi i vonuar i vdekjes me Aktvendim në LAV pas 2 muajve;	5 50
1.3. Regjistrimi i martesave të lidhura jashtë Kosovës; Kompletimi i dosjes për aplikim të lirim dhe fitim të shtetësisë.	10 20
1.4. Lidhja e martesës jashtë institucionit dhe jashtë orarit të punës;	30
1.5. Lidhja e martesës jashtë orarit të punës brenda institucionit;	15
1.6. Lidhja dhe regjistrimi i martesës në LAM me procesverbal;	5
1.7. Lidhja dhe regjistrimi i martesës në LAM me shtetasin e huaj me procesverbal;	30
1.8. Marrja e Aktvendimit mbi ndryshimin e emrit personal në LAL dhe LAM;	30
1.9. Përmirësimi i germëzimit të emrit personal;	3
1.10. Anulimi i regjistrimit të lindjeve në dy komuna;	10
2. Lëshimi i certifikatave të statusit civil	
2.1. Ekstrakti i lindjes;	1
2.2. Certifikata e lindjes;	1
2.3. Certifikata e martesës;	1
2.4. Certifikata e vdekjes;	1
2.5. Certifikata e statusit martesor;	4
2.6. Certifikata e statusit jetësor;	5
2.7. Certifikata e vendbanimit;	1
2.8. Certifikata e shtetësisë;	2

2.9. Kërkesë për lirim të shtetësisë;	5
2.10. Kërkesë për fitimin e shtetësisë;	5
3. Vërtetimet e gjendjes civile	
3.1. Vërtetimi mbi konfirmimin e emrit personal;	5
3.2. Vërtetimi mbi mjetet për jetesë;	5
3.3. Vërtetimi i nënshkrimit përshkrimit dhe dorëshkrimit;	2
3.4. Vërtetime të ndryshme;	5
3.5. Njohja e ndryshimit të emrit nga regjistrimi në botën e jashtme, Njohja e Vendimit nga shteti i huaj për ndryshim të emrit.	10
3.6. Vërtetimi në botën e jashtme	5
4. Vërtetimi i deklaratave	
4.1. Deklarata e bashkësisë familjare;	2
4.2. Deklaratë e gjendjes personale të personit fizik;	2
4.3. Dëshmi mbi vdekjen dhe përshkrimin e pasurisë; (Aktvdekja)	2
5. Përpilimi dhe parashtrimi i shkresave-kërkesave	
5.1. Parashtrimi i kërkesave të ndryshme drejtuar organeve komunale	1

Neni 3
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

1. Dhënia e aktit për kushte tekniko-urbanistike për zonat që nuk kanë plan rregullues urban	Shuma në €
1.1. Për parcelimin e parcelës;	30
1.2. Muret rrethuese;	10
1.3. Për objekte të përkohshme-afariste;	20
1.4. Për objekte ndihmëse;	2
1.5. Për garazhe;	15
1.6. Kërkesa për shfrytëzimin të dokumentacionit të shërbimeve Pronësores-Juridike për banesa;	5
1.7. Për vazhdimin e Lejes për ndërtim dhe lëshimi i LN duplikat;	30
1.8. Vërtetime dhe pelqime të ndryshme	10
2. Taksat për leje ndërtimi	
2.1. Për ndërtimin e objektit të të gjitha llojeve;	2.56 € m ²
2.2. Tarifa rregullative për destinim të infrastrukturës për objekte për banim (m ² /50)*99.87 p.sh. (100/50)*99.87=199.74€;	Tarifa e llog.99.87
3. Lëshimi i lejes komunale mjedisore sipas UA Nr.17/2015 01/2017	0.2% të vlerës investive
3.1. Tarifat në vlerën investive të projektit deri 25,000 euro	50
3.2. Tarifat në vlerën investive të projektit mbi 25,000 euro	0.2% të vlerës investive
3.3. Lëshuarja e vendimit për leje përdorimi për objekt individual shtëpi banimi;	30

3.4. Lëshuarja e vendimit për leje përdorimi për objekt shumëbanesore për çdo banesë;	20
3.5. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale afariste brenda objektit shumëbanesor;	20
3.6. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale afariste individuale;	30
3.7. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për lokale objekte industriale.	100
3.8. Lëshuarja e certifikatës së përdorimit për hotele, motele dhe restorante.	80
4. Leje tjera	
4.1. Leje për vendosja e foltoreve telefonike;	10
4.2. Leje për shtrirjen e rrjetit kabllor(ajror) të internetit, për metër gjatësi;	0.05
4.3. Leje për shtrirjen e rrjetit elektrik(ajror) për metër gjatësi;	0.03
4.4. Leje për vendosje e ormanëve shpërndarëse MDF, për copë;	15
4.5. Leje për ndërtimin-vendosjen e trafove elektrike;	20
4.6. Leje për vendosjen e antenave;	20
4.7. Leje për përvoja nëntokësore: kanalizim, ujësjellës, rrjet kabllor elektrikë, rrjetë kabllor të internetit etj, për metër gjatësi.	0.06
5. Kompensimi për tokën ndërtimore të cilën Komuna e ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm paguhen për një vit.	
5.1. Sipërfaqja prej 1-10 m ² , në lartësi prej;	60
5.2. Sipërfaqja prej 11-30 m ² , në lartësi prej;	80
5.3. Sipërfaqja prej 31-50 m ² , në lartësi prej;	100
5.4. Sipërfaqja mbi 51-m ² , në lartësi prej.	120
6. Taksat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike përkohësisht.	
6.1. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një ditë;	10
6.2. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një javor;	15
6.3. Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla të përkohshme–sezonale, në të cilat kryhet veprimtaria tregti, reklamim malli e të tjera shfrytëzimi një muaj;	20
6.4. Leje për vendosjen e tavolinave para lokaleve hoteliereve për m ² –mujore	2
7. Vendosja e pllakateve reklamuese në hapësira publike tarifa vjetore për m²	
7.1. Pllakatet;	20
7.2. Pllakatet reklamuese me ndriçim;	30
7.3. Vendosja e reklamave elektronike reklamuese;	100
7.4. Vendosja e reklamave në muret e ndërtesave për m ² ;	30
7.5. Vendosja e banereve-mujore	20
8. Ngarkesat për organizimin e lodrave argëtuese, të fatit dhe lojërave argëtuese automatike të ndryshme.	
8.1. Vendosja e aparateve për lojëra argëtuese , ngarkesa mujore për çdo aparat sipas llojit;	20
8.2. Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese). Tarifa mujore për m ² .	0.50
9. Shërbime tjera	
9.1. Leja për vendosjen e materialit ndërtimor, druve, thëngjilli etj . në hapësirat publike për 24 orë.	10

10. Trifat e shërbimeve dhe produkteve kadastrale rregullohen sipas UA. Nr. 05/2012 MMPH	
10.1. Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike ne terren deri në 0.5 ha;	75
10.2. Për çdo ndarje në pjesë tjetër;	25
10.3. Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike ne terren 0.5–1ha;	100
10.4. Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike ne terren 1-5 ha;	150
10.5. Ndarja e parcelës së përcaktuar më parë;	80
10.6. Ndarja e më tepër së dy pjesë, të përcaktuar më parë, për çdo pjesë;	40
10.7. Ndarja e komplekseve me sipërfaqen prej 5 –10 ha në dy (2) pjesë;	200
10.8. Për çdo ndarje në pjesë tjetër;	100
10.9. Ndarja e komplekseve me sipërfaqe mbi 10 ha, në dy (2);	500
10.10. Për çdo ndarje në pjesë tjetër.	200
11. Bashkimi i parcelave	
11.1. Bashkimi i dy (2) parcelave pa matje;	20
11.2. Për çdo parcelë tjetër në kufi.	10
12. Matja e ndërtesave	
12.1. Matja për një ndërtesë individuale për një metër katror të bazës Gjeodezike;	0.50
12.2. Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë-për një metër katror të bazës gjeodezike;	0.25
12.3. Ndërtesë banimi kolektiv-për një metër katror;	0.50
12.4. Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë-për një metër katror;	0.50
12.5. Ndërtesa afariste-për një metër katror;	0.70
12.6. Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë-për një metër katror;	0.70
12.7. Ndërtesa banesore-afariste-për një metër katror;	0.70
12.8. Çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë-për një metër katror;	0.50
12.9. Ndërtesë e administratës qeveritare dhe publike-për një metër katror;	0.50
12.10. Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë-për një metër katror;	0.50
12.11. Objekte për sport dhe rekreacion (stadione, halla sportive etj.)-për një metër katror;	0.50
12.12. Objektet kulturore dhe fetare-për një metër katror;	0.30
12.13. Për çdo ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë-për një metër katror.	0.50
13. Matjet e pjesëve të ndërtesave	
13.1. Hapësirat banesore dhe përpilimi i skicës për një metër katror;	0.80
13.2. Kati me skica të njësive të veçanta për m ² ;	0.70
13.3. Hapësirat afariste dhe përpilimi i skicës për një metër katror;	1
13.4. Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës-për çdo pjesë për një metër katror;	0.75
13.5. Ndarja e hapësirave afariste dhe përpilimi i skicës-për çdo pjesë.	0.75
14. Matjet e përçojave	
14.1. Përçoja nëntokësore për metër gjatësi;	0.50
14.2. Përçoja mbitokësore për metër gjatësi;	0.25
14.3. Objekte nëntokësore;	100
14.4. Për çdo objekt tjetër;	50
14.5. Tunelet, për metër gjatësi.	5

15. Përcaktimi i kufijve të parcelave	
15.1. Për një parcelë me sipërfaqe gjer 0.50 ha;	80
15.2. Për sipërfaqe prej 0.50 ha deri 1.00 ha;	100
15.3. Për çdo hektar tjetër mbi një(1) hektar;	60
15.4. Për parcelat urbane sipas planit urbanistik (pas marrjes së pëlqimit nga Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit).	120
16. Rirregulimi i kufijve të parcelave	
16.1. Për një parcelë me sipërfaqe gjer 0.50 ha;	40
16.2. Për sipërfaqe prej 0.50 ha deri 1.00 ha;	50
16.3. Për çdo hektar tjetër mbi një (1) hektar.	30
17. Dhënia e dëshmimeve nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesave të palëve nga Zyra kadastrale komunale	
17.1. Dhënia e vërtetimeve të ndryshme;	3
17.2. Certifikata mbi pronën;	4
17.3. Kopje e planit për një parcelë;	5
17.4. Për çdo parcelë tjetër;	2
17.5. Historiati për një parcelë;	30
17.6. Kopja e hartës kadastrale A ₀ letër e thjeshtë 1:500 dhe 1:5.000.	20
18. Punët sipas kërkesave të palëve në zyre	
18.1. Identifikimi i njësive kadastrale në terren-për njësi të kadastrave;	20
18.2. Për çdo njësi tjetër në kufi;	5
18.3. Kontrolli dhe regjistrimi në regjistrin e të dhënave nga terreni për njësi të kadastrave.	20
19. Punët të veçanta gjeodezike	
19.1. Bartja në terren e të dhënave nga planet urbanistike për objekte Individual për m ²	0.50
19.2. Bartja në terren e të dhënave nga planet urbanistike për objekte banimi kolektiv apo afarist për m ²	0.50
20. Baza gjeodezike Pikat trigonometrike:	
20.1. Koordinatat Y, X me përshkrim.	5
21. Pikat lidhëse:	
21.1. Koordinatat Y, X me përshkrim.	4
22. Pikat poligonale:	
22.1. Koordinatat Y, X,Z me përshkrim.	3
23. Pikë reper:	
23.1. Koordinatat Y, X,Z me përshkrim.	5
24. Pikat në linjë:	
24.1. Koordinatat Y, X,Z me përshkrim.	2
25. Pikat e detajit:	
25.1. Koordinatat Y, X;	1
25.2. Vendosja e pikave trigonometrike.	50
Tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronë së paluajtshme bëhen sipas UA të MMPH Nr.08/2014	
26. Regjistrimi i pronës në bazë të transaksioneve (shitblerjes)	

26.1. Në vlerën deri në 10.000 €;	20
26.2. Në vlerën prej 10.000-30.000 €;	30
26.3. Në vlerën prej 30.000-50.000 €;	35
26.4. Në vlerën prej 50.000-100.000 €;	50
26.5. Mbi vlerën 100.000 €, për çdo 50.000 € tejkalim paguhet vlera prej 30€ nuk mund të kaloj vlerën prej 300€;	
26.6. Për kontrata ku vlera e kontratës nuk është caktuara.	70
27. Regjistrimi i pronës në bazë të dokumentit mbi dhuratën	
26.1. Nëse është e caktuar vlera e dhuratës dhuratëmarrësi është anëtarë i familjes dhe pasardhës paguhet 30% të tarifave nga paragrafi 22 sipas vlerave për çdo pronar;	
27.2. Nëse është e caktuar vlera e dhuratës dhuratëmarrësi nuk është anëtarë i familjes dhe pasardhës paguhet tarifa nga paragrafi 22 sipas vlerave për çdo pronar;	
27.3. Nëse nuk është e caktuar vlera e dhuratës dhuratëmarrësi është anëtarë i familjes dhe pasardhës paguhet tarifa për çdo anëtar;	50
27.4. Nëse nuk është e caktuar vlera e dhuratës, dhuratëmarrësi nuk është anëtarë i familjes dhe pasardhës paguhet tarifa për çdo anëtar;	80
26.5. Regjistrimi i pronës në bazë dokumentit të organeve Administrative dhe Gjyqësore, mbi njohjen e të drejtës së pronësisë.	50
28. Regjistrimi i pronës në bazë të pjesëtimit të pronës në bashkëpronësi	
28.1. Regjistrimi i pronës në bazë të një akti juridik për vendosjen e bashkëpronësisë;	20
28.2. Regjistrimi i pronës në bazë të një akti juridik për ndarjen fizike të bashkëpronësisë për çdo pronarë fizik i ri;	20
28.3. Regjistrimi i pronës në bazë të një akti juridik për pronën e përbashkët të bashkëshortëve;	20
28.4. Regj. i pronësisë së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi;	20
28.5. Regjistrimi i pronës së përbashkët të ndërtesave në bashkëpronësi me të gjithë pronaret e pjesëve të veçanta.	100
29. Regjistrimi i pronës në bazë të trashëgimisë dhe shkëputjes së bashkësisë familjare	
29.1. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të trashëgimisë për çdo trashëgimtar;	10
29.2. Regjistrimi i pronës, posedimit në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtar të familjes që bahet pronarë;	10
29.3. Regjistrimi i pronësisë, posedimit në bazë të ndërrimit të pronës së paluajtshme.	30
30. Regjistrimi i hipotekave	
30.1. Kërkesa për vlerën deri në 10.000 €;	10
31.2. Kërkesa për vlerën prej 10.000-30.000 €;	20
32.3. Kërkesa për vlerën prej 30.000-50.000 €;	30
33.4. Kërkesa për vlerën prej 50.000-100.000 €;	80
34.5. Kërkesa mbi vlerën 100.000 €, për çdo 100.000€ tejkalim paguhet edhe nga 30€ por shuma e pagesës nuk mund të kalon vlerën e 400€;	
35.6. Ndryshimi i hipotekës;	30
36.7. Fshirja e hipotekës.	10
310. Regjistrimi i servituteve	
31.1. Regjistrimi i drejtës së servitutit;	50

31.2. Fshirja e drejtës së servitutit.	20
32. Regjistrimi i drejtës së shfrytëzimit-qirambajtja	
32.1. E drejta e shfrytëzimit në kohëzgjatje prej 3-10 vite;	50
32.2. E drejta e shfrytëzimit në kohëzgjatje prej 10-25 vite;	150
32.3. E drejta e shfrytëzimit në kohëzgjatje deri në 99 vite;	500
32.4. Fshirja e së drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes është 20% e shumës së paguar për regjistrimin e të njëjtës;	
32.5. Nenëqiraja paguhet sipas tarifave nga paragrafi 28.	
33. Regjistrimi i barrëve dhe ngarkesave të ndryshme	
33.1. Regjistrimi i barrës në tatim në pronë;	20
33.2. Regjistrimi i barrës tatimore;	30
33.3. Regjistrimi i masës së sigurisë (Masa e përkohshme) me procedurë gjyqësore me kërkesë private të palës;	50
33.4. Regjistrimi i drejtave tjera;	40
33.5. Korrigjimi i të dhënave në regjistër sipas dokumenteve të dorëzuara nga pala.	20

**Neni 4.
Drejtoria për Buxhet e Financa**

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Dhënia e certifikatave	
1.1. Dhënia e Certifikatave për vlerësimin e patundshmërive me Komision;	50
1.2. Dhënia e Certifikatave mbi gjendjen ekonomike;	2
1.3. Dhënia e certifikatave mbi përmbushjen obligimeve tatimore si dhe dhënia e Certifikatave që nuk kanë obligime tatimore.	1
2. Taksa për Automjetet Motorike	
2.1. Për automjetet që peshon deri në 3.5 ton;	10
2.2. Për automjete mbi 3.5 ton.	20

**Neni 5
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim**

Emërtimi dhe përshkrimi dokumenteve	
1. Ngarkesa për afarizëm vjetor, për pije alkoolike	
1.1. Ngarkesa vjetore për lejimin e përdorimit të pijeve alkoolike për hotele dhe motele;	60
1.2. Ngarkesa vjetore për lejimin e përdorimit të pijeve alkoolike për Kafiteri dhe restorante.	20
2. Ngarkesa për zgjatjen e orarit të punës	
2.1. Ngarkesa për zgjatjen e orarit të punës për një ditë;	30
2.2. Ngarkesa për zgjatjen e orarit të punës për ndermarrjet hoteliere, motele, restorante dhe kafeteri për një muaj;	300
2.3. Ngarkesa për zgjatjen e orarit të punës për ndermarrjet tregtare për një muaj;	50
2.4. Ngarkesa për zgjatjen e orarit të punës për barnatore për një muaj.	10

Neni 6
Drejtoria për Arsim

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1. Participimet për vijim të fëmijëve në kopshte	
1.1. Participimi në baza mujore për kopshte të fëmijëve në Istog, Gurakc dhe Banjë;	25
1.3. Participimi në baza mujore për kopshte të fëmijëve në Vrellë dhe Rakosh.	20
2. Participim për mësimin joformal	
2.1. Për regjistrim të vitit;	100
2.2. Për vijimin e mësimit praktik;	50
2.3. Për provimet përfundimtare të klasave-certifikatë;	30
2.4. Për diplomë të përfundimit të shkollimit;	20
2.5. Provimi diferencial	10
3. Pagesat për dokumentacionit shkollore	
3.1. Pagesa për nxjerrjen e diplomës duplikat;	1
3.2. Pagesa për nxjerrjen e dëftesës duplikat;	1
3.3. Certifikata për kryerjen e ciklit fillor 1–5 duplikat;	1
3.4. Certifikata për kryerjen e nivelit 6–9 duplikat;	1
3.5. Certifikata për kryerjen e arsimit të obliguar duke i përfshirë dy nivelet 1–9 duplikat;	1
3.6. Vërtetimet e ndryshme të cilat i kërkojnë ish nxënësit (palët) si në arsimin e obliguar ashtu edhe në arsimin e mesëm të lartë;	1
3.7. Për dëftesat e lëshuara kandidatëve që kanë të kryer shkollimin e obliguar sipas sistemit të vjetër të arsimit.	1
4. Shfrytëzimi i hapësirës në Sh.K. “Adem Jashari”	
4.1. Salla e madhe e koncerteve fitimprurëse për një mbrëmje;	200
4.2. Holli për mbrëmje rinore (një natë);	50
4.3. Salla e gjelbër (për një ditë);	10
4.4. Shkolla e “kembrixhit” (për muaj);	150
4.5. Anëtarësimi në bibliotekë për nxënës deri në klasën e nëntë.	2
4.6. Anëtarësimi në bibliotekë për të gjithë të tjerët.	3

Neni 7
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve të shërbimit	Shuma €
1. Lëshuarja e vërtetimeve dhe shkresave të ndryshme nga Drejtorati	
1.1. Vërtetim për lirim nga participimi;	1
1.2. Formular për shërim në botën e jashtme; te hiqet	0
1.3. Vërtetim për arsyetimin e shpenzimeve të varrimit për botën e jashtme;	3
1.4. Pëlqimi sanitar për licencim të ordinancave private;	10
1.5. Kërkesa të ndryshme të palëve;	1
1.6. Vërtetimi që nuk kanë sigurim shëndetësor në Kosovë;	3
1.7. Formular për shtesa të fëmijëve në botën e jashtme;	1

1.8. Raport për inspektimin sanitar;	10
1.9. Leje për Ekshumimin e Kufomave.	50
2. Çmimorja e bashkë pagesave për shërbime shëndetësore në nivelin parësorë, sipas Udhëzimit Administrativ 4/2007 të Ministrisë së Shëndetësisë	
2.1. Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostiko me aparaturë;	1
2.2. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të familjes;	2
2.3. Ekzaminimi specijalistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut Familjar;	5
2.4. Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente;	6
2.5. Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike;	0.30
2.6. Ultrazëri standard;	2
2.7. Radiografia;	2
2.8. EKG;	0.50
2.9. Analiza laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina;	1
2.10 Analiza laboratorike komplet;	3
2.11. Caktimi i sheqerit në gjak në glikometër, sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	1
2.12. Audiograma;	1
2.13. Shpëlarja e veshit;	1
2.14. Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente;	1
2.15. Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente;	1
2.16. Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës, vetëm në vizitën e parë;	3
2.17. Trajtimi ditor me infuzione në institucione shëndetësore;	1
2.18. Certifikatat për lejen e vozitjes, të lëshuara nga komisioni Profesional;	20 18
2.19. Certifikata e mjekut e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	20
2.20. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;	5
2.21. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore për shtetasit e huaj;	25
2.22. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive për 1 orë;	25
2.23. Vendosja, heqja e kateterit Urinuar; te hiqen te dyjat	3
2.24. Heqja e trupave të huaj (nga veshi, hunda, syri dhe heqja e rrigrave).	2
3. Çmimorja e pagesave për shërbime stomatologjike të nivelit parësor-QKMF të Komunave dhe QMF	
3.1. Vizita e parë stomatologjike;	1
3.2. RTG i dhëmbit;	1.50
3.3. Mbushja e përhershme me amalgamë;	4
3.4. Mbushja e përhershme me kompozitë;	5
3.5. Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	5
3.6. Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6

3.7. Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.8. Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.9. Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.10. Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë);	6
3.11. Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme;	6
3.12. Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës;	1
3.13. Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave;	1
3.14. Vulosja e fisuarave;	1
3.15. Mënjanimi i depozitimeve të buta;	1
3.16. Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurësve të dhëmbëve me ultratingull);	3
3.17. Kiretazha e xhepave paradental (një dhembë);	1
3.18. Nxjerrja e dhëmbit;	1.50
3.19. Incizioni infra dhe extra oral;	1.50
3.20. Heqja e kurorës me anë të prerjes;	1
3.21. Riparimi i protezës.	1.50
4. Shfrytëzimi i Autoambulancës me kërkesë të klientit pa referim të mjekut e që nuk janë raste Emergjente	
4.1. Relacioni Istog-Pejë;	10
4.2. Relacioni Istog-Prishtinë;	30
4.3. Relacioni Istog-Tiranë;	150 100
4.4. Relacioni Istog-Shkup;	150 100
5. Çmimet e Pagesave për Shërbime në Qendrën Sociale	
5.1. Certifikata që nuk i është hequr zotësia e Veprimit e vlefshme për 1 vit;	10
5.2. Konstatimi që nuk ka obligime ligjore (Alimentacion) ndaj personave përgjegjës ligjor (për heqje të Nënshetësisë të Republikës së Kosovës);	30 10
5.3. Konstatimi që posedon mjete material për ekzistencë (për marrje të nënshetësisë të Republikës së Kosovës);	10
5.4. Pëlqim për bashkim familjar në botën e jashtme.	10
5.5. Certifikata shendetesore për edukim dhe shkollim	10

Neni 8
Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Shërbimet/aktivitetet	Shuma €
1. Zhvendosja – bllokimi dhe vendqëndrimi i automjeteve të konfiskuara	
2. Lejet për ndërhyrje në infrastruktura dhe hapësira tjetër publike	
2.1. Leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare për 1m ² ;	50
2.2. Leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve, kubzave të betonit, beton etj për 1m ² .	25
3. Procesi për plotësimin e kushteve teknike për auto-taksi, autobus dhe kamion	

3.1. Për automjete deri në 5 ulëse;	10
3.2. Për kamionët e lehtë deri 3.5 T, traktorë;	20
3.3. Për kamion, autobus, minibus dhe mjete tjera të rënda;	30
4. Shërbime tjera	
4.1. Leja për vendosjen e materialit ndërtimor, druve, thëngjilli etj . në hapësirat publike për 24 orë.	10
5. Leje për bllokim të rrugës (shiritit rrugor-trotuarit)	
5.1. Zona urbane-12 orë;	20
5.2. Zona urbane-24 orë;	25
5.3. Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 ditë;	5
5.4. Leja për ndalje(ngarkim shkarkim)të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 muaj;	20
5.5. Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni për 1 vit;	80
5.6. Leje për auto taxi 4+1 ulëse, për 1 vit;	50
5.7. Leje për kombi bus 8+1 ulëse (Leje e veçanet për transportin e nxënësve të mësimi fillor), për 1 vit;	60
5.8. Leja(Licenca) për operator të transportit publik të udhëtarëve (autobusëve) lëshohet për 5 vite;	100
5.9. Ndërrimi i Lejes për auto-taxi (nënkuptohet kur nga pronari ndërrohet automjeti para skadimit të Leje që është pajisur me parë);	15 10
5.10. Vërtetimi i rendit të udhëtimit për linjën e rregullt të udhëtareve dhe për transport të veçanet, Operatori transportues paguan taksën për një vit (për një relacion-nisje të caktuar);	25
5.11. Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtar (Autoparku).	20
6. Lejet për automjetet e rënda transportuese me peshë prej 3.5-7.5 ton, të cilat kanë nevojë për të qarkulluar në ato rrugë (qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndaluar.	
6.1. Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë;	10
6.2. Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë;	20
6.3. Leje e lëshuar për një muaj;	30
6.4. Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen herë pas here.	80
7. Lejet për automjetet e rënda transportuese me peshë mbi 7.5 ton, të cilat kanë nevojë për të qarkulluar në ato rrugë (qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunikacionit e kanë të ndaluar;	
7.1. Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë;	15
7.2. Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë;	25
7.3. Leje e lëshuar për një muaj;	40
7.4. Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen herë pas here;	100
8. Parkingje publike shiritore	
8.1. Në parkingjet publike me shirita të ndarë në rrugë, trotuar-tarifa vjetore për persona fizik;	60
8.2. për persona juridik.	100

9. Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike per rrugë lokale dhe zona urbane	
9.1. Lëshimi i pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për çdo kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore, pa shirita qarkullues përcjellës;	30
9.2. Vërtetime të ndryshme	5
9.3. Lëshimi i pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për çdo kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore, me shirita qarkullues përcjellës.	40

Neni 9
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

1. Emërtimi dhe përshkrimi i dokumenteve	Shuma në €
1.1. Certifikatë për shitjen e prodhimeve bujqësore; te hiqet	5
1.2. Certifikatë për dëmet në bujqësi; Vleresimi i demeve ne Bujqesi dhe Pylltari	10
1.3. Pëlqim nga komuna per shfrytezim dhe seperacion te burimeve dhe minerale; bazuar ne ligjin nr.03/L-163 neni 31 nenparagrafi 1.13	50
1.4. Pëlqimi për ndërrimin e tokës bujqësore në atë jo bujqësore;	10
1.5. Taksë për ndërrimin e destinimit të tokës sipas klasave;	I-IV-1€/m ² V-VII-0. 75 €/m ² VII-VIII-0. 50 €/m ²
1.6. Certifikatë shëndetësore sipas llojit te kafshëve sipas Urdh. Adm. Nr.17/2005 (MBPZHR);	20% nga shuma e përcaktuar me UA
1.7. Pëlqim për licencim të shitjes së plehrave minerale, pesticideve;	10
1.8. Vërtetim për veprimtari bujqësore;	5
1.9. Te hyrat nga pylltaria ne baze te Ligjit Nr.03/L-153 te datës 25.02.2010 dhe Çmimore per prodhime pyjore;	30% nga të Hyrat

Neni 10

Të gjitha borxhet e krijuara nga personat fizik dhe juridik që nuk janë shlyer deri me tani zbatohen Rregulloret e viteve paraprake dhe duhet të paguhen sipas Rregulloreve paraprake të cilat në këto pjesë janë në fuqi.

Neni 11
Gjjobat

1. Gjjobat e shqiptuara për kundërvajtje në trafik i takojnë Komunës. Alokimi i mjeteve të arkëtuara bëhet sipas dispozitave të rregullave të thesarit. Mjetet e arkëtuara mund të jenë si rrjedhojë e arkëtimit nga dënimet mandatore, përmes Policisë së Kosovës dhe vendimeve përfundimtare të Gjykatës Themelore Pejë-Dega në Istog.
2. Për mospagimin e taksave dhe ngarkesave të përcaktuara në këtë rregullore, në afatin të cilin e përcakton organi zyrtar përkatës, **do të pasojnë gjjobat. do te iniciohet procedura permbarimore.**
3. Për gjjobat mandatorë zbatohen Ligjet në fuqi.
4. Për mbrojtjen e mjedisit zbatohen gjjobat mandatore sipas Udhëzimit Administrativ Nr.14/2015 i miratuar nga MMPH.

Neni 12
Afati

1. Afati për pagesën e të gjitha gjobave gjegjësisht dënimeve të shqiptuara është 8 (tetë) ditë nga dita e shqiptimit të dënimit nga ana e inspektorit.
2. Në rast se përfaqësuesi i subjektit afarist nuk e bënë pagesën në afatin e caktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, ndaj tij do të iniciohet procedura kundërvajtësve pranë Gjykatës Themelore Pejë-Dega në Istog.

Neni 13

Mbikëqyrja dhe Zbatimi

Kryetari i Komunës përmes Inspektorëve Komunal është i obliguar të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Rregulloreje dhe të ndërmarr masa dhe veprime përkatëse sanksionuese, inicimin e procedurës kundërvajtës, shqiptimin e masave tjera ndëshkuese dhe gjobave në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 14

Lirimi nga pagesa e taksave

1. Nga pagesa e taksave për kryerjen e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë, nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhënia e certifikatave mbi gjendjen ekonomike, dhe **vërtetimeve** për tatimin në pronë, lirohen: anëtarët e familjeve të Dëshmorëve të Luftës, familjeve të viktimave civile të luftës, invalidët e luftës, veteran të luftës, pensionistët, shfrytëzuesit e ndihmës sociale, personave me aftësi të veçanta dhe studentët.
2. Personat e verbër lirohen nga pagesa e të gjitha taksave komunale që i parasheh kjo Rregullore, bazuar në nenin 6 të Ligjit për personat e verbër Nr.04/L-092 të vitit 2011.
3. Kategoritë e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk lirohen nga dënimi me gjobë sipas nenit 63 të Ligjit për Gjendjen Civile me Nr. 04/L-003 të vitit 2011.
4. Nga pagesa e taksës për parashtrimin e kërkesave të përcaktuara me nenin 2, paragrafi 5 dhe nënparagrafin 5.1 të kësaj rregulloreje, lirohen të gjitha kategoritë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, përfaqësuesit e komuniteteve të cilët parashtrajnë kërkesë në interes të komunitetit, të gjithë ata që parashtrajnë kërkesë për ndihmë shëndetësore, për ndihmë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, ndihma për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si dhe kërkesat për ndihma tjera.
5. Nga pagesa e taksës të përcaktuar me nenin 6, paragrafi 4 dhe nënparagrafin 4.1 lirohen personat fizik dhe juridik për organizimin e koncerteve për qëllime humanitare.
6. Personat të cilët u përkasin kategorive të lartcekura janë të obliguar që të sjellin dëshmi përkatëse për tu liruar nga pagesa.
7. Nga pagesa e taksave sipas nenit 3 paragrafi 5 i kësaj Rregulloreje lirohen OJQ jo fitim prurës dhe organizatat humanitare.

Neni 15

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet: Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores komunale për Taksat Ngarkesat dhe Gjobat Nr.1/2017, mbesin në fuqi rregulloret e viteve paraprake sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kryesuesi i Kuvendit
Qaush Balaj